



A.nr.412/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.412/2026, të datës 08.04.2026, të parashtruar nga ankuesi D.Zh, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Shkelqim Jakupi nga Fushë Kosova, në çështjen juridike-administrative “*kundërshtim i masës disiplinore*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 10.06.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.412/2026, të datës 08.04.2026, e parashtruar nga ankuesi D.Zh.

A r s y e t i m

Ankuesi, D.Zh. (*tutje referuar ankuesi*), më datë 08.04.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.412/2026, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” e shqiptuar përmes shkresës me numër 439 të datës 03.04.2026, të Drejtoreshës për Administratë të Komunës pranë Fushë Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Fushë Kosovës, ndërsa, kjo e fundit ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së lidhur me këtë çështje juridike-administrative janë plotësuar kërkesat ligjore për pezullimin e procedurës administrative, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 15.09.2020 është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari* në Drejtorinë për Administratë. Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton së Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë në cilësi të mbikëqyrëses se ankuesit, përmes shkresës me numër të protokollit 439 të datës 03.04.2026, ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje me shkrim” me arsyetimin së gjatës vizitës më datë 02.04.2026 rreth orës 14:00, ankuesi nuk ka qenë prezent në vendin e caktuar të punës në zyrën e gjendjes civile në bardhë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në këshillin e pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës, pretendon se masa disiplinore e shqiptuar ndaj tij është shqiptuar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të LPPA-së dhe detyrimeve të LZP-së, shkeljeve të procedurës administrative dhe disiplinore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material. Po ashtu pretendon se masa disiplinore është shqiptuar nga personi jokompetent sepse shqiptimi i masave të lehta disiplinore mund të bëhet vetëm nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo udhëheqësi më i lartë administrativ (ZKA), vërejte kjo e shqiptuar në mungesë të përgjegjësisë disiplinore, mungesë të provave si dhe duke shkelur parimin e ligjshmërisë. kërkon që të aprovet ankesa si dhe të anulohet masa disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Kolegji i këshillit bazuar në analizimin e shkresave të lëndës ka gjetur se masa disiplinore e atakuar më ankesë është shqiptuar si pasojë e kërkesës nr. 287 të datës 13.03.2026, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, për kthimin e ankuesit nga Drejtoria e Planifikimit Urban të Drejtoria sipas akt emërimit, kërkesë kjo e kontestuar në KPMSHCK nga ankuesi përmes ankesës A.nr.413/2026, të datës 08.04.2026.

Andaj, mbi këto rrethana, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së çështja ankimore e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.413/2026, është parakusht për zgjidhjen e ankesës me numër A.nr.412/2026, dhe si e tillë përben çështje paraprake, kështu që, në kuptim të nenit 85, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përmbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”, Kolegji vendosi që të pezullohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.412/2026, të datës 08.04.2026, deri në vendosje të ankesës me numër A.nr.413/2026 të datës 08.04.2026.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.412/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Avokatit Shkelqim Jakupi;
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së